

PROF. ISLAM ZEKO DHE BASHKËPUNËTORËT

MISJA K.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Muzeu i Shkencave të Natyrës

Prof. Islam Zeko, ose si e njihnim të gjithë Prof. Lamja, u lind në Gjirokastrë në vitin 1914; pasi mbaroi studimet e larta në Francë në 1940, filloi punën si mësues në shkollat e mesme të vendlindjes e më pas të Tiranës. Në vitin 1946 ishte përgjegjës i Sektorit të Biologjisë dhe Kimisë në Institutin e Lartë Pedagogjik 2-vjeçar të porsahapur; në 1951 ishte përgjegjës i Katedrës së Biologjisë në Institutin e Lartë 4-vjeçar.



Prof. Zeko ishte themeluesi i Katedrës së Zoologjisë, qysh me hapjen e Universitetit të Tiranës më 1957, dhe e drejtoi atë thujse për tri dekada. Ai bëri punë të kualifikuar e të gjithanshme, duke qënë në krye të grupeve për hartimin e planeve e të programeve mësimore teorike e praktike, organizoi ngritjen e laboratorëve mësimorë etj. Profesori ishte lektori i parë në auditorët tona i disa lëndëve të ndryshme biologjike, si: Zoologji Invertebrore dhe Vertebrore, Histologji-Embriologji, Metodikë e Biologjisë etj.; ai hartoi leksionet dhe tekstet e para të këtyre lëndëve, më të cilat u arsimuan me qindra studentë, u kualifikuan me qindra mësues biologjie.

Ndihmesa për arsimin nuk përfshiu vetëm shkollën e lartë; ai ndoqi vazhdimisht me vëmendje dhe është marrë me shumë probleme të mësimdhënies së biologjisë në shkollën e mesme dhe 8-të vjeçare, duke qënë pjesëmarrës aktiv në hartimin e programeve dhe të disa teksteve të këtyre shkollave. Për njohuritë, erudicionin dhe përvojën e madhe që kishte, në vitin

1969 u caktua anëtar i Komisionit të Arsimit të Lartë për modernizimin e mëtejshëm të shkollës. Duke filluar nga viti 1970, profesori zhvilloi për vite me radhë leksionet e Zoologjisë dhe të Anatomisë së Krahasuar edhe në Universitetin e Prishtinës; edhe aty ai mori vlerësimet dhe konsideratat më të larta.

Prof. Zeko u aktivizua në veprimtari të ndryshme shkencore në fushën e Zoologjisë, veçanërisht në atë të ornitologjisë, kryesisht me shpendët grabitqarë, që ai i studioi dhe shkroi për to. Për këtë grup ai u dërgua dhe në Fakultetin e Biologjisë së Universitetit të Moskës, pranë katedrës së Zoologjisë Vertebrore dhe Ekologjisë dhe Muzeut të Zoologjisë të Universitetit të Moskës; këtu u vlerësua për njohuritë në fushën e zoologjisë vertebrore dhe njohuritë për larminë e shpendëve të Shqipërisë. Në atë kohë unë isha student në Moskë dhe pata rastin ta shoqëroj dhe ta ndihmoj si përkthyes; në të vërtetë, profesori si njohës i shkëlqyer i frëngjishtes gjeti gjuhën e komunikimit dhe të punës me disa nga profesorët e njohur rusë të zoologjisë dhe ekologjisë shtazore.

Prof. Zeko është autor i shumë studimeve, të pasqyruara në disa artikuj shkencorë. Përkushtim të madh bëri për inventarizimin e shpendëve të Shqipërisë; sëbashku me Prof. Fotaq Lamanin ata përgatitën materialin monografik për Shpendët e Shqipërisë, i cili ndonse i vonuar pret të botohet dhe të zërë vend në botimet e pakta për faunën e Shqipërisë. Ai ka kumtuar në shumë veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Profesori ishte i lidhur ngushtë dhe me Muzeun e Shkencave të Natyrës, duke dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e punës dhe pasurimin e fondit shkencor të tij. Për shumë vite me radhë ai ishte anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe i Redaksisë së Buletinit të Shkencave Natyrore. Mendimet dhe këshillat e tij ishin gjithmonë shumë të vyera dhe shkencore dhe zinin vend në punën e këtyre forumeve.

Ndihmesë të veçantë, nxitëse dhe profesionale dha profesori edhe në kualifikimin pasuniversitar të punonjësve mësimorë-shkencorë të Katedrës. Ai orientoi, hartoi, udhëhoqi edhe mbrojtjet e para për punimet për gradën shkencore Kandidat i Shkencave dhe Doktor; në ato vite, Katedra e Zoologjisë ishte mjedis diskutimesh për artikujt shkencorë, disertacionet, recensat, mbrojtjet në Katedër dhe në Këshillin Shkencor të Fakultetit.

Katedra dhe Fakulteti ishin për Prof. Lamën familja e vërtetë, ku ai kalonte thujse tërë kohën; me ta ai nuk desh të ndahej për asnjë çast. Si drejtues i Katedrës ai qe mjaft korrekt dhe i kujdesëshëm, ndiqte mbarëvajtjen në leksione e punë laboratorike; nga përvoja e tij, kishte se çfarë të fliste e të kontrollonte për procesin e mësimdhënies, nivelin shkencor të tij, dhe

metodikën e ecurisë të punës mësimore. Në mbledhjet e Katedrës, fliste më pak, dëgjonte më shumë dhe bënte vlerësime e këshilla shumë të vlefshme për punën shkencore, punën mësimore dhe veprimtari të tjera të punonjësve. Për meritat e tij në veprimtari shkencore e mësimore, Prof. Islam Zeko është dekoruar me titullin Mësues i Merituar, si dhe është dekoruar me urdhëra e medalje të ndryshme.

Në kujtesën e të gjithëve Prof. Lamja mbahet mend si misionari i diturisë, që pak, fare pak mendoi për vete, duke ju përkushtuar vetëm arsimit, dhe në veçanti arsimit të lartë; ai ishte fjalëpak dhe shumë modest. Që në fillim shquhesh për cilësitë e veçanta në mësimdhënie, për saktësinë, qartësinë, dhe mbi të gjitha për mënyrën e përsosur të zhvillimit të mësimin. Ai mbetet i paarrtshëm për nivelin e lartë shkencor të leksioneve, për parashtrimin shumë metodik, për komunikimin e shkëlqyer me auditorin. - *Nuk mungoj sot, kam leksion me Prof. Lamjen*, - që kjo një shprehje që dëgjohej gjithmonë në koridoret e Fakultetit; kjo mëshironte dëshirën për ta dëgjuar atë, për të skalitur në mendje çdo skicë apo figurë që ai e stilizonte me aq pasion e saktësi shkencore, dhe për të marrë sa më shumë nga bagazhi i madh i njohurive që ai i shpaloste aq këndshëm në leksione; nuk i hapej kujt goja gjatë leksioneve të profesorit.

Në planin personal ai ishte i veçantë, i mirë, i urtë, i sjellshëm, modeli i qytetarisë, modeli i qendrisur si për askënd i tipareve më njerëzore; nuk lëndoi kurrë kënd gjatë jetës së tij; nuk i tha kujt një fjalë ofenduese, nuk përshtëpiti kurrë një fjalë thashethemnjaje; e kishte të vështirë të ngrinte zërin. Përkundrazi, Prof. Lamja ishte i interesuar për hallet e të tjerëve si për veten, i gatshëm për të ndihmuar këdo; ashtu i heshtur dhe modest, ai ishte i pranishëm me tërë qënien e tij në secilin prej antarëve të Katedrës, të cilët nga ana e tyre e donin dhe e respektonin.

Dëshira e Prof. Lames ishte të vdiste 'me shkumës në dorë'. Por ai u bë viktimë e fillimit të tranzicionit shqiptar, në verë të vitit 1989; ky Njeri i nderuar u gjet i vdekur, i masakruar në mënyrë makabre në shtëpinë e tij, ku ai banonte i vetëm. Për këtë fund të dhimbshëm dhe të mistershëm, për fat të keq drejtësia sot ende nuk ka hedhur dritë. Në këto çaste përkujtimi, ne ish kolegët dhe ish nxënësit përulemi me mirënjohje të thellë përpara Figurës së Profesor Islam Zekos, dhe njëkohësisht bashkojmë zërin për më shumë vlerësim dhe drejtësi për të. I paharruar qoftë kujtimi i tij!

Bashkohës dhe bashkëpunor i Prof. Lames ka qënë dhe pedagogu dhe punonjësi shkencor, Stiliano Gaxho. Pas mbarimit të studimeve të larta në Itali, Gaxho punoi në punë të ndryshme, të lidhur dhe me aspektet zoologjike; më vonë u emërua pedagog e punonjës shkencor në Katedrën e Zoologjisë,

nga ku dhe doli në pension. I paisur me njohuri të gjera zoologjike dhe kryesisht entomologjike, ai që mjaft bindës dhe i vërtetë në punë shkencore, mjaft i saktë dhe konkret në leksionet e Metodikës së Përgatitjes së Objekteve Zoologjike, në praktikat në terren dhe në laborator. Studentët dhe kolegët e donin sepse i tërhiqte erudicioni mbresëlënës i Stilianit, thjeshtësia e gjithanshme dhe komunikimi për punët në Katedër. Krahas procesit të mësimdhënjes, Gaxho u muarr shumë me aktivitet shkencor, kryesisht në fushën e entomologjisë së zbatuar. Punimet e tij në lidhje me mizën e ullirit dhe tenjën e rrushit qënë të nivelit të lartë, dhe me vërtetësi bindëse. Artikujt shkencorë të botuara për to në Buletinin e Shkencave Natyrore tërhoqën vëmendjen e specialistëve të huaj dhe për to pati shumë kërkesa duke filluar nga Izraeli. Duke qënë njohës i përkryer i gjuhëve latine, ai përktheu dhe shumë vepra të shkencëtarëve të huaj sidomos për florën. Gaxho ka mjaft punime shkencore të pasqyruar në artikujt shkencorë të botuar në Buletinin e Shkencave Natyrore dhe atyreve Bujqësore.

Pedagogu Bajazit Shehu (1924-1991) ka lënë, gjithashtu, gjurmë në kujtesën e studentëve dhe të kolegëve të Katedrës së Zoologjisë. Pas mbarimit të studimeve në Universitetin e Odesës, Shehu punoi si pedagog në Institutin e Lartë Bujqësor, dhe më vonë pranë Katedrës sonë të Zoologjisë, ku ai zhvilloi lëndët e Fiziologjisë Shtazore, dhe atë të Anatomisë së Njeriut. Ishte gjithmonë me humor të admirueshëm, dhe njëkohësisht një lektor i përsosur, shumë i përgatitur, elokuent; fjala e tij i tërhiqte studentët, që gjithënjë mbushnin sallën e leksioneve. Ai që nismëtar i përfshirjes së të rejave shkencore në leksione dhe aktivitet praktik; ishte nxitësi i përfshirjes në planet mësimore të degës së Biologjisë i lëndëve të reja mësimore, si Gjenetika, Ekologjia dhe i rifutjes të Embriologji-Histologjisë etj. Shehu bëri punë të madhe frytdhënëse duke nxitur diskutimet midis kolegëve dhe studentëve për modernizimin e planeve mësimore të degës.



Pas mbarimit të studimeve në Universitetin e Odesës, Sami Perihana ishte një tjetër koleg që filloi punën pranë Katedrës së Zoologjisë; ai ishte fillimisht

pedagog i Darwinizmit, lëndë të cilën e zhvillonte dhe në Fakultetin e Mjekësisë. Në leksionet e tij kishte nuanca të këndëshme të tregimtarit, gjë që i tërhoqte shumë dëgjuesit; e dëgjonin, e kundronin ashtu të futur të tërin, si në ëndërrime në *'debatin e zhvilluar në Universitetin e Oksfordit midis shkencëtarit të madh dhe priftit profan'*; ishte vërtet lektor për t'u dëgjuar. Më vonë punoi në Universitetin e Shkodrës dhe sërish në Katedrën e Zoologjisë, ku tashmë Darwinizmi po ia lëshonte vendin Teorisë së Evolucionit dhe Biologjisë së Përgjithshme, që ai filloi t'i studjojë me kujdes. Krahas punës mësimore, zhvillonte edhe punë kërkimore në fushën e vërtebrorëve, të gjitarëve dhe shpendëve, por ngarkesa e lartë mësimore nuk jepte fushë të gjerë veprimi. Për fat të keq, Perihana u nda në moshë të re nga studentët dhe kolegët e tij, por ka mbetur dhe do të mbesë në kujtesën e tyre.

Pas mbarimit të studimeve në Institutin Bujqësor për Mbrojtjen e Bimëve në Shën Petërburg (Leningrad), në vitin 1957, Xhelo Murraj u emërua në Katedrën e Zoologjisë. Në vitin 1964 emërohet zv/drejtor në Institutin Pedagogjik 'Aleksandër Xhuvani' në Tiranë. Në vitin 1967 punon si Bashkëpunor Shkencor i Parë në Institutin e Lartë Bujqësor, ku zhvillon leksionet e Entomologjisë në degën e Agronomisë. Në vitin 1971 punon si Bashkëpunor Shkencor në Institutin e Fizikës Bërthamore, dhe më pas në 1974 emërohet drejtor i Laboratorit të Luftës Biologjike, ku punoi deri në fund të aktivitetit të tij (1991).



Aktiviteti 34 vjeçar i punës kërkimore-shkencore dhe pedagogjike, brenda dhe jashtë Universitetit të Tiranës, është pasqyruar në shumë botime të Xh. Murraj, si Manual i Dëmtuesve të Kulturave Bujqësore, Probleme të Biologjisë së Tokës Bujqësore, si dhe disa artikuj shkencorë dhe publicistikë të botuar në buletine shkencore dhe revista periodike; gjithashtu, ai ka botuar edhe tekstet mësimore të Zoologjisë, Zoogeografisë, Sistematikës së Insekteve, Mbrojtje e Bimëve etj.; ka projektuar dhe drejtuar disa laboratorë shkencorë; ka udhëhequr diploma studentësh dhe kualifikim e kuadrosh bujqësorë; ka referuar në konferenca shkencore kombëtare dhe

ndërkombëtare. Murraj është autor i 14 skenarëve për filma dokumentarë-shkencorë për prodhimin bujqësor dhe mbrojtjen e bimëve dhe është çmuar me çmimin Aleksandër Mojsiu dhe urdhërin Naim Frashëri. Gjithashtu, Murraj është vlerësuar me medalje argjendi nga Qendra Ndërkombëtare e Biografive (Angli); në 1991 është vlerësuar në Enciklopedinë Ndërkombëtare të Kembrixhit (Angli) si Shkencëtar i Mijëvjeçarit; është vlerësuar, gjithashtu, me Statujën e Artë nga Instituti Biografik Amerikan.

Në fund të këtij shkrimi përulemi me mirënjohje dhe respekt për Profesor Islam Zekon dhe ish kolegët e tij të sipërpërmendur, por edhe për mjaft të tjerë që nuk patëm mundësi t'i përmendënim. Ata nuk janë sot midis nesh, por kujtimi i tyre do të mbetet gjithmonë i paharruar në kujtesën e gjithë ish studentëve dhe të kolegëve të tyre, duke u bërë burim frymëzimi për të sotmen dhe të ardhmen e Arsimit të Lartë në Shqipëri.